

Aktivitetet në Qendrën e Zhvillimit Ditor "Trendafila"

Aktivitetet psiko-edukativ



Në institucion vëmendje e vecantë i është kushtuar zhvillimit dhe mbarëvajtjes së procesit psiko – edukativ. Rol të rëndësishëm për realizimin e procesit social-edukativ ka patur zbatimi i programeve me natyrë rehabilituese dhe integruese. Zbatimin e një plani të diferencuar në përputhje me nevojat e klientëve të vendosur në institucion ka bërë të mundur zhvillimin me sukses të rubrikave me natyrë njohëse, krijuese. Zhvillimi i oreve me përmbajtje të tilla si:

Zhvillimi intelektual, gjuhe, matematike, kënd konstruktiv, njohja me formën dhe përmbajtjen e objekteve rrethuese dhe ndërtimi i tyre me kuba, këndi i pikturës, bërja e vijave të drejta përdorimi i ngjyrave të ujit, ngjyrosja e figurave të ndryshme kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e autonomisë personale për njohjen, përshtatjen dhe identifikimin e ambientit rrethues.

Si rezultat i vijimisë së përkujdesit shëndetësor nuk janë evidentuar raste problematike në shëndetin e klientëve, kontrolli i herë pas hershëm ka bërë të mundur një situatë relativisht të mirë si nga pikpamja e higjienës ashtu dhe nga pikpamja e shëndetit të klientëve.

Aktivitetet sociale

Organizimi i aktiviteteve festive ka patur një rol të pazëvendësueshëm në jetën sociale dhe emocionale të klientëve. Përveç festave të 7-8 marsit, ditëlindjeve të klientëve, shëtitjeve të organizuara etj, këtë vit për herë të parë drejtoria e Qendrës ka organizuar pushime dy javore në plazhin e Shëngjinit me të gjithë klientët e institucionit. Klientët dhe stafi janë akomoduar gjatë kësaj kohe në shtëpinë e motrave të Shëngjinit dhe për dy javë kanë qëndruar 24 orë non stop atje. Kemi punuar me përkushtim ditë diele dhe ditë feste pa e llogaritur kohën.



1 Qershori

Gjatë asaj kohe kemi festuar 1 Qershorin ditën Ndërkombëtare të fëmijëve. Me rastin e kësaj feste kemi përgatitur dhe shfaqur me kliente një koncert festiv ku fëmijët kanë recituar, kënduar, konkuruar në disa fusha si; ngjyrosje, vizatim, shkrim, lojëra formuese etj.

Të pranishëm në festë ishin përfaqësues të organizatave jo qeveritare që operojnë në qytetin e Lezhës si përfaqësues të Word Vision, Kryqi i Kuq të cilët bënë disa dhurata për klientet tanë. Aktiviteti u filmua nga mediat e qytetit të Lezhës dhe të Shkodrës.

Olimpiku Special



Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kohore disa klientë kanë marrë pjesë në Olimpikun Special që u organizua në Tiranë në muajin maj 2008.

3 Dhjetori

Në institucion kemi përkujtuar 3 Dhjetorin Ditën Ndërkombëtare të PAK. Në kujtim të kësaj dite kemi shfaqur një program artistik me recitime, kënge, lojra, konkurse etj. Të ftuar ishin përfaqësues nga Bashkia, Zyra Rajonale e ShSSH, përfaqësues të OJF etj. Mesazhi i asaj dite ishte: Të drejta të barabarta, integrim shoqëror, jetë të denjë në gjirin e shoqërise për këto persona.

Festat e fundvitit dhe Dita Ndërkombëtare për Të drejtat e Fëmijëve

Janë festuar festat e fundvitit në institucion me fëmijë dhe prindër të klientëve. Në ditën ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve një pjesë e fëmijëve të institucionit tonë kanë marrë pjesë në manifestimin paqësor që u zhvillua në qytetin e Lezhës në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Këtë pjesëmarrje e kemi bërë të mundur në bashkëpunim me OJF e Qytetit si me World Vision, Kryqin e Kuq dhe Bashkinë Lezhë.